

**Obstetrikë** (Ostetricia)

## **Donacionet pas lindjes (Donazioni post-parto)**

# **GJAKU I KORDONIT DHE INDE PLACENTARE (Sangue cordonale e tessuti placentari)**

ULSS 2 | Donacionet pas lindjes

*Çdo nënë e ardhshme mund të zgjedhë të bëjë një gjest me vlerë të madhe duke dhuruar gjak të kordonit dhe ind placentar.*

*Dhurimi është i sigurt, pa dhimbje dhe nuk përfshin asnjë rrezik as për nënën, as për të porsalindurin.*

*Është një gjest bujarie që do të ndihmojë në trajtimin e njerëzve në nevojë.*

### **GJAKU I KORDONIT (IL SANGUE CORDONALE)**

#### **Cfarë është (Cos'è)**

Është gjaku i të porsalindurit që mbetet në placentë dhe në kordonin e këthizës pas prerjes së kordonit. Ai përmban qeliza staminale hematopoietike (CSE) të çmuara, pra të specializuara në formimin e elementeve të pranishme në gjak.

#### **Pse ta dhuroni (Perché donarlo)**

Në Itali, çdo vit, mesatarisht 1700 pacientë kanë nevojë për transplant të qelizave staminale hematopoietike që të shërohen. Kur nuk gjeni një dhurues të përshtatshëm në familje, duhet ta kërkoni atë midis dhurimeve të gjakut të kordonit dhe midis dhuruesve të disponueshëm në Regjistrin Italian të Donatorëve të Palcës Kockore.

#### **Si ta dhuroni atë (Come donarlo)**

Të gjithë çiftet që presin një fëmijë mund të kenë akses në procesin e dhurimit, i promovuar edhe nga mamitë në kurset e përgatitjes për lindjen. Rreth një muaj para lindjes, është planifikuar një mbledhje me maminë për të konstatuar përshtatshmërinë dhe për të nënshkruar pranimin e informuar.

Grumbullimi i gjakut të kordonit bëhet pas lindjes midis 60 dhe 120 sekondash pa asnjë rrezik për nënën dhe të porsalindurin.

Për informacione dhe takime, kontaktoni Shoqatën e Donatorëve të Qelizave Staminale Hematopoietike (ADoCeS) në departamentin e Mjekësisë Transfuzione të spitalit Treviso, tel. 0422 405179

### **PROJEKTI "FËMIJA DHURON, BABAI DHURON" (IL PROGETTO "BIMBO DONA, PAPÀ DONA")**

"Fëmija dhuron, babai dhuron" është një projekt i promovuar nga (associazione donatori cellule staminali emapoietiche) ADoCeS dhe i sponsorizuar nga Rajoni Veneto. Është pjesë e

procesit të dhurimit të gjakut të kordonit që çifti ka zgjedhur dhe që babai mund ta përmirësojë nëpërmjet regjistrimit të tij në regjistrin italian të dhuruesve të palcës kockore.

Dhurimi bëhet me një gjakmarrje të thjeshtë nga një krah që zgjat 3-4 orë. Vetëm në 10% të rasteve dhurimi bëhet me mbledhjen e palcës kockore nga kockat e legenit. Disa linke të dobishme mund të arrihen përmes kodeve QR të mëposhtme.

Babai që dëshiron të bashkohet me projektin mund të gjejë të gjithë informacionin e nevojshëm në faqen e internetit të ADoCeS. (Paragrafo accanto al primo codice QR)

Në seksionin "Regjistrohu" të faqes është e mundur të regjistroheni paraprakisht në platformën (ADoCeS) të lidhur me Regjistrin e Donatorëve (IBMDR). (Paragrafo accanto al secondo codice QR)

Shoqata organizon një webinar çdo të martë të fundit të muajit në orën 17.30 për të folur për projektin "Fëmija dhuron, babai dhuron", dhurimi i gjakut të kordonit dhe qelizave staminale hematopietike.

Lidhja për webinarin është në seksionin e Ngjarjeve në Facebook @adocesfederazione.it. (Paragrafo accanto al terzo codice QR)

## **INDI PLACENTAR (I TESSUTI PLACENTARI)**

Fondacioni Banca dei Tessuti del Veneto ETS është institucioni referues i kujdesit shëndetësor i Rajonit Veneto i cili ka për detyrë mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e indeve homologe, duke vërtetuar gjurmueshmërinë, përshtatshmërinë dhe sigurinë e tyre.

## **MEMBRANA AMNIOTIKE (LA MEMBRANA AMNIOTICA)**

### **Cfarë është (Cos'è)**

Placenta është një organ që formohet gjatë shtatzënisë dhe është përgjegjëse për ushqimin, mbrojtjen dhe mbështetjen e rritjes së fetusit. Është e mbuluar nga një film i çmuar, membrana amiotike, e pajisur me veti të rëndësishme rigjeneruese, antiinflamatore dhe analgjezike të cilat lehtësojnë shenjat dhe shërimin e patologjive të ndryshme.

### **Pse ta jepni (Perché donarla)**

Dhurimi i placentës për nxjerrjen e membranës amiotike përmirëson kushtet e jetesës së shumë pacientëve shpesh të lidhur me terapi të gjata dhe të dhimbshme. Membrana amiotike mund të përdoret në kirurgji dermatologjike për trajtimin e djegieve të thella, ulçerave kronike, plagëve të vështira. Përdoret gjithashtu në fushën e oftalmologjisë, neurokirurgjisë, kirurgjisë maksio-faciale, kirurgjisë së përgjithshme dhe ortopedisë.

### **Si ta dhuroni atë (Come donarla)**

Placenta mund të dhurohet në rast të prerje cezariene të planifikuar pas javës së 36-të (në shtatzëni binjake tashmë nga e 33-ta). Në momentin e planifikimit të prerjes cezariene, mamia do të propozojë mbledhjen e placentës dhe e membranave. Placenta e mbledhur ne

menyr sterile gjatë prerjes cezariane do të dërgohet më pas në bankën e indeve për përpunimin e saj. Mbledhja nuk përfshin asnjë rrezik për nënën dhe të porsalindurin.

### **VENA KËRTHIZORE (LA VENA OMBELICALE)**

#### **Cfarë është (Cos'è)**

Është një enë gjaku e vendosur brenda kordonit të kërthizës. Është pjesë e qarkullimit të placentës fetale dhe transporton gjakun me oksigjen dhe lëndët ushqyese tek fëmija.

#### **Pse ta jepni (Perché donarla)**

Falë karakteristikave të sajë të veçanta përdoret veçanërisht në kirurgjinë vaskulare në rast të zëvendësimit të një proteze të infektuar, rivaskularizimit të gjymtyrëve të poshtme, bajpasit femur-popliteal.

#### **Si ta dhuroni atë (Come donarla)**

Vena e kërthizës përdoret falë dhurimit të placentës së mbledhur gjatë prerjes cesariane, me pranimin e nënës dhuruese.

### **QENDRA E KONSULTAVE (CONSULTORI FAMILIARI)**

Gjatë kursit përgatitor për lindjen ose gjatë kontrolleve, mamia e klinikës mund të japë të gjitha indikacionet në lidhje me dhurimin e gjakut të kordonit ose dhurimin e placentës.

Rrethi shëndetsorë Asolo

Rrethi shëndetsorë Pieve di Soligo

Rrethi shëndetsorë Treviso veriore

Rrethi shëndetsorë Treviso jugore

Dokumenti është hartuar nga një grup profesional i Njësisë Operative dhe Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun.  
Përditësimi i prillit 2023